



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:041934
Datë: 06.09.2024
Numri i dokumentit: 06129869

C-IV-13-2208

Ankuesi

E K, Hani i Elezit.

Kundër

E paditura

NSH.PMN,, Sharr” (në likuidim), e përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakërishtë- Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtaren Ganimete Puka, me 06 shtator. 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** ankesa e ankuesit si e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.GJI042-4222 i dt.25.shtator. 2013.
- II. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit E K, në emër të kompensimit për 40 %, të paga të papaguara për periudhën Janar 2004- dhjetor 2010, t’i paguaj **shumën prej 13.148.00 €**, në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 08.dhjetor. 2013, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankese /kundërshtim të Vendimit nr. **GJI042-4222, dt.25.shtator.2013**, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ka kërkuar që të kompensohet 40 %, të pagave të papaguara në shumën prej 13.148.00€. nga NSH PMN“Sharr”, Ankuesi e kundërshton vendimin e AL-së për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit të së drejtës materiale, dhe AKP, gabimisht ka konstatuar se kërkesa është e parashkruar . Ankuesi pohoi se, kundër vullnetit të tij, me vendimin

nr.620/2003, dt.01.12.2003, është dërguar në pushim me pagës për 60%, dhe ka fituar procesin gjyqësorë sipas aktgjykimeve të Gjykatave të Kosovës, dhe kërkesa e tij është e bazuar. Ankuesi i propozon gjykatës, që ankesën e tij ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Ankuesi ka dorëzuar si provë: vendimin e kundërshtuar të AL, librezën e punës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dt.09.dhjetor.2010, vendimin, nr. 620/2003, dt.01.12.2003, aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC.nr.580/2006, dt.10.07.2006, aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ref.nr.190/2006, dhe aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kaçanik, C.nr.24/-4, dt 03.12.2004, i plotfuqishëm me dt.23.06.2005.

Me 01.shkurt. 2017, e paditura parashtroi përgjigje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe së dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi së ankuesi nuk ka treguar së cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi së kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Ankuesi i kërkon paga të papaguara për periudhën janar 2004. në shumën prej 13.148.00€ . E paditura pohoi së kërkesa e ankuesit është parashkruar dhe nuk ka prova që ankuesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare të parashkrimit, pra tri vite nga muaji janari i vitit 2004. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Me 20.shkurt.2017, ankuesit ka dhënë përgjigjen ndaj mbrojtjes, duke kundërshtuar në tersi kundërshtimet e AKP, dhe mbet në tersi pranë pretendimeve dhe propozimeve të dhëna në ankesë, me propozim që ankesa të aprovet dhe të ndryshohet vendimi i kundërshtuar.

Me 06.mars.2017, AKP, në kundërpërgjigje ka mbet në tersi ndaj kundërshtimeve dhe propozimeve të dhëna në mbrojtën me shkrim, me propozim që ankesat të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtresave të palëve.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovet si e bazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par. 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa, par.3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i N.SH "SHARR.", në Kaçanik. Nuk ishte kontestues se ankuesi, së bashku me disa punëtor të tjerë kundër vullnetit të tyre ishin dërguar në pushim me pagës për 60%. Nuk ishte kontestues as fakti se ankuesi si dhe punëtorët e tjerë, e kishin fituar procesin gjyqësorë me të gjitha intencat gjyqësore. Nuk ishte kontestues as lartësia e shumëve të kërkuar nga ankuesi në emër të 40%, në shumë prej 13.148.00€, nga janari i vitit 2004, deri kur ankuesi ishte njoftuar për ndërprerje të marrëdhënies së punës për shkak të procesit të privatizimit të NSH.

Në këtë çështje si kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për 40 %, të pagës së papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi e kundërshton një pretendim të tillë duke u bazuar në aktgjykimet e Gjykatave të Kosovës, me konkretisht aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kaçanik, C.nr.24/04, dt 03.12.2004, i plotfuqishëm me dt.23.06.2005, si dhe në njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dt 09. Dhjetor.2010, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

I padituri nuk e ka kundërshtuar bazën dhe lartësinë e kërkesës së ankuesit. Në një çështje civile një fakt i pretenduar nga njëra palë në kontest nëse nuk kontestohet gjatë procesit kontestimor, konsiderohet si fakt i vërtetuar dhe mbi atë fakt mund të bazohet vendimi gjyqësor.

Gjykata konstaton se ankuesit ka ofruar prova -dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh 40 %, të pagave të kërkuara, këtë nuk e ka mohuar e paditura, dhe kjo vërtetohet edhe me provat në shkresat e lëndës, siç janë aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC.nr.580/2006, dt.10.07.2006, aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ref.nr.190/2006, dhe aktgjykimin të Gjykatës së Komunale Kaçanik, C.nr.24/04, dt 03.12.2004, i plotfuqishëm me dt.23.06.2005, pra ankuesi i dëshmoj kësaj gjykate se kishte fituar procesin gjyqësorë për kthimin në vendin e punës, me të gjitha të drejta dhe detyrimet që i kishte nga marrëdhënia e punës, pra ankuesi arriti ti provoj kërkimet e tij, për t'ju njohur e drejta e pretenduar në ankesë.

Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, është plotësisht e pa

saktë. Ankuesi ka dorëzuar prova që vërtetojnë faktin se kishte të themeluar marrëdhënien e punës me të paditur nga viti 1967, deri kur ishte dërguar në pushim me pagesë 60%, në dhjetor 2003, pastaj pas disa proceseve gjyqësore të fituara, e paditura ishte detyruar që ankuesin si dhe punëtorët të tjerë që ti kthej në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, që nënkupton pagës e pjesë së pagese prej 40%. Edhe pse ankuesi nuk dorëzoi provë së kishte kërkuar përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kërkesa e ankuesit nuk është e parashkruar, vendimet gjyqësore janë obligative për palët, këtë e paditura e kanë në dijeni, mbi të gjitha në rastin konkret afati i parashkrimit është ndërprerë me njoftimin e dt 09.dhjetor.2010. Ankuesi kërkesën para AL e ka parashtruar brenda afati për dorëzimin e kërkesave dt. 02.qershor.2011, që do të thotë që kërkesa për 40 % të pagës së papaguara nuk është parashkruar.

Pra në një situatë të tillë, gjykata nxjerr përfundim së kërkesa e ankuesit nuk është e parashkruar Ankuesi me njoftimin e datës 09.dhjetor. 2010, ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrorë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit. Njehe rit një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (AC-I-20-0282, AC-I-20-0033, AC-I-20-0168, AC-I-20-0183, si dhe rastet për të njëjtën NSH AC-I.-22-0474, AC-I.-22-0518 etj).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Andaj në bazë të te lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrorë ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimete Puka

G j y q t a r e